

201909801238

LIGJ PËR SHËRBIME (*)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen dispozitat e përgjithshme për të drejtën e themelimit dhe lirisë së dhënies së shërbimeve në Republikën e Maqedonisë, organizimin e Pikës së Vetme për kontakt në tregun e shërbimeve, lidhjen me Sistemin Informativ për Tregun e Brendshëm të Bashkimit Evropian, koordinimin dhe bashkëpunimin e përbashkët me palët kontraktuese shtetërore të Marrëveshjes për themelimin e Hapësirës Ekonomike Evropiane.

Fushëveprimi i zbatimit

Neni 2

(1) Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me:

- 1) masat për liberalizimin e shërbimeve me interes publik për subjektet publike ose private;
- 2) privatizimin e subjekteve publike ose personave tjerë juridikë që kryejnë shërbime me interes publik;
- 3) ndërprerjen e bashkimeve monopole në kryerjen e shërbimeve dhe të ndihmës të përfshirë me rregullat për mbrojtjen e konkurrencës;
- 4) llojin e shërbimeve që janë me interes të përgjithshëm dhe mënyrën e kryerjes dhe financimit të tyre në pajtim me rregullat për ndihmën shtetërore;
- 5) rregullat për mbrojtjen dhe promovimin e llojllojshmërisë gjuhësore, trashëgimisë së patundshme kulturore në pajtim me ligjin dhe pluralizmin mediatik;
- 6) rregullat nga sfera e së drejtës penale;
- 7) kushtet për punësim, për siguri dhe shëndet në/gjatë punës, të marrëdhënies së punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëtorit dhe çështjeve lidhur me sigurimin social të rregulluara me ligje të veçanta;
- 8) zbatimin e marrëveshjeve kolektive të lidhura ndërmjet partnerëve socialë.

(2) Dispozitat e këtij ligji zbatohen në shërbimet që i japin dhënësit e shërbimeve të themeluara në Republikën e Maqedonisë dhe në shtetet e HEE-së me përjashtim të:

- 1) shërbimeve joekonomike me interes publik;
- 2) shërbimeve financiare, siç janë sistemi bankar, kreditimi, sigurimi dhe risigurimi, lizingu financiar, pensionet profesionale ose personale, letrat me vlerë, fondet investuese, shërbimet këshillëdhënëse për investim, duke i përfshirë edhe aktivitetet financiare të përcaktuara me nenin 2 pika 34 të Ligjit për banka;
- 3) shërbimeve nga sfera e komunikimeve dhe rrjeteve elektronike, mjeteve shoqëruese si dhe shërbimeve tjera që janë rregulluar me Ligjin për komunikime elektronike dhe aktet nënligjore që dalin nga ky ligj në lidhje me qasjen dhe interkoneksionin e komunikimeve elektronike dhe rrjeteve dhe mjeteve shoqëruese, lejeve për komunikimet elektronike dhe rrjeteve dhe shërbimeve, shërbimin universal dhe të drejtat e shfrytëzuesve në lidhje me komunikimet elektronike dhe rrjetet dhe shërbimet dhe shfrytëzimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike;

* Me këtë ligj bëhet harmonizimi me Direktivën 2006/123/BE të Bashkimit Evropian për shërbimet në tregun e brendshëm, CELEX numër 32006L0123

4) shërbime në sferën e transportit, duke i përfshirë transportin urban, taksi shërbimet, transportin me mjetet e ndihmës së shpejtë dhe limanet;

5) shërbimeve të agjencive për punësime të përkohshme;

6) shërbimeve shëndetësore, pa marrë parasysh nëse ato i sigurojnë institucionet shëndetësore publike, organizatat ose institucionet shëndetësore private ose shoqëritë tregtare që kryejnë veprimtarinë e mbrojtjes shëndetësore si dhe mbrojtjen shëndetësore dhe shërbimet e mjekëve që i japin punëtorët shëndetësorë;

7) shërbimeve audio dhe vizuale, duke i përfshirë shërbimet kinematografike, pa marrë parasysh mënyrën e tyre të prodhimit, shpërndarjes dhe transmetimit si dhe veprimtarinë radiodifuzive;

8) aktiviteteteve nga sfera e lojërave të fatit, në pajtim me Ligjin për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese;

9) shërbimeve që lidhen me realizimin e autorizimeve zyrtare;

10) shërbimeve sociale nga sfera e përkujdesjes sociale, përkujdesjes së fëmijëve dhe ndihmës familjare dhe ndihmës së individëve që kanë nevojë nga ndihma e përhershme ose e përkohshme të cilën e jep shteti, dhënësit ose organizatat bamirëse të pranuarra me ligj;

11) shërbimeve të sigurimit privat;

12) shërbimeve që i japin noterët dhe përmbaruesit dhe

13) aktiviteteteve që dalin nga sfera e tatimit dhe

14) ndihmës juridike dhe kryerjes së autorizimeve publike që i ofron avokatia si shërbim publik i mëvetësishëm dhe i pavarur.

Zbatimi i ligjit dhe ligjeve të veçanta

Neni 3

(1) Nëse dispozitat e këtij ligji janë në kundërshtim me dispozitat e ligjit të veçantë me të cilin rregullohen shërbimet e caktuara të rregulluara me Ligjin për punësim dhe punë të huajve në lidhje me dispozitat për punëtorët e zhvendosur me qëllim të dhënies së shërbimeve, Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në lidhje me dispozitat për kryerjen e emetimit televiziv, Ligjin për njohjen e kualifikimeve profesionale në lidhje me dokumentet dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe rregullave nga sfera e koordinimit të sistemeve të sigurimit social të personave të punësuar, personave të vetëpunësuar dhe anëtarëve të familjeve të tyre, atëherë vlejnë dispozitat e atij ligji të veçantë.

(2) Nëse me dispozitat e këtij ligji nuk përcaktohet ndryshe në të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me profesionet e rregulluara dhe njohjen e kualifikimeve profesionale për qëllimet e dhënies së shërbimeve, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e ligjeve të veçanta për profesionet e rregulluara dhe njohjen e kualifikimeve profesionale.

(3) Nëse me dispozitat e këtij ligji nuk përcaktohet ndryshe, në të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punët administrative për qëllimet e dhënies së shërbimeve, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Përkufizimet në Ligj

Neni 4

Për qëllimet e zbatimit të këtij ligji nocione të caktuara e kanë kuptimin si vijon:

1) “shërbim” është aktiviteti i pavarur ekonomik i cili kryhet për kompensim dhe nuk është rregulluar me ligje dhe rregulla me të cilat rregullohet qarkullimi i mallrave, kapitalit dhe personave;

2) “dhënës i shërbimit” është personi fizik shtetas i Republikës së Maqedonisë ose i shtetit të Napësirës Ekonomike Evropiane (në tekstin e mëtejshëm: “shteti i HEE-së”) ose personi juridik me selinë e themeluar në Republikën e Maqedonisë ose në shtetin e HEE-së i cili ofron ose jep shërbime;

3) “pranues i shërbimit” është personi fizik shtetas i Republikës së Maqedonisë ose i shtetit të HEE-së ose personi juridik me selinë e themeluar në Republikën e Maqedonisë ose në shtetin e HEE-së i cili shfrytëzon ose dëshiron ta shfrytëzojë shërbimin për qëllimet e veta profesionale ose joprofesionale;

4) “shtet i themelimit” është Republika e Maqedonisë ose shteti i HEE-së ku dhënësi i shërbimeve është themeluar;

5) “seli” është vendi prej ku menaxhohet me kryerjen faktike të aktiviteteve ekonomike nga ana e dhënësit të shërbimeve në Republikën e Maqedonisë në kohë të pacaktuar dhe përmes infrastrukturës ekzistuese;

6) “dhënie tejkuftare e shërbimeve” është dhënia e shërbimeve në bazë të përkohshme në një vend nga dhënësi i shërbimit me seli të themeluar në vendin tjetër;

7) “procedurë e miratimit” është procedura e përcaktuar me ligj ose rregullë tjetër në të cilën dhënësi i shërbimit ose pranuesi i shërbimit duhet të përmbush kërkesa të veçanta me qëllim nga organi kompetent të marrë vendim formal ose implicit në pajtim me të cilën e fiton të drejtën e qasjes në tregun e shërbimeve (në tekstin e mëtejshëm: pëlqim);

8) “kërkesë” është çdo obligim, ndalim i përcaktuar, kusht ose kufizim në ligj ose rregullë ose është pasojë juridike që ndodh si rezultat i zbatimit të vendimit gjyqësor ose vendimit të organit tjetër kompetent, ose rregullave të shoqatave dhe organizatave profesionale, të miratuara gjatë kryerjes së fushëveprimit të tyre të kompetencës, përveç dispozitave të përmbajtura në marrëveshjet kolektive të lidhura ndërmjet partnerëve socialë;

9) “shkaqe jashtëzakonisht të rëndësishme me interes publik” janë shkaqet që janë përcaktuar me ligj ose si të tilla janë pranuar në praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, ndërsa i përfshijnë: politikën publike, mbrojtjen publike, sigurinë publike, shëndetësinë publike, baraspeshën financiare të sistemit të mbrojtjes sociale, mbrojtjen e konsumatorëve, të pranuesve të shërbimeve dhe të punëtorëve, transaksioneve të drejta tregtare, luftën kundër mashtrimit, mbrojtjen e mjedisit jetësor, mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, ruajtjen e vlerave historike nacionale dhe trashëgimisë artistike dhe kulturore, masat e politikës sociale, masat e politikës kulturore për ruajtjen e kulturës nacionale dhe identitetit nacional;

10) “organ kompetent i Republikës së Maqedonisë” është subjekti i cili në kryerjen e kompetencës së vet të mbikëqyrjes dhe/ose rregullatorit miraton vendim për kërkesë për qasje në tregun e shërbimeve, duke i përfshirë veçanërisht: organet e administratës, trupat profesionalë dhe shoqatat profesionale ose organizatat tjera profesionale që japin pëlqim;

11) “profesion i rregulluar” është profesioni për kryerjen e të cilit ekzistojnë kushte të përcaktuara ligjore nga aspekti i llojit, shkallës së arsimit si dhe kualifikimeve profesionale;

12) “komunikim komercial” është forma e komunikimit të dedikuar për tregun e mallrave dhe shërbimeve me të cilën realizohet promovimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i mallrave dhe shërbimeve ose portfolios së një ndërmarrjeje afariste konkrete të shoqërisë tregtare ose personit fizik dhe juridik që kryen veprimtari tregtare ose të zejtarisë ose veprimtari të caktuar si profesion të tij. Komunikimi komercial nuk paraqet vetvetiu informatë për adresën e postës elektronike ose për adresën elektronike të subjektit ose në rast të bëhet fjalë për komunikimin e realizuar në lidhje me mallrat, shërbimet ose portfolion e subjektit që bazohet në të dhënat e grumbulluara në mënyrë të pavarur, veçanërisht kur kjo nuk ka për qëllim fitimin e dobisë financiare;

13) “Sistem informativ i tregut të brendshëm” (në tekstin e mëtejshëm: “IMI sistem”) është sistemi informativ i tregut të brendshëm me të cilin sigurohet shkëmbimi i informatave ndërmjet organeve dhe trupave kompetente të shteteve të HEE-së;

14) “palë kontraktuese shtetërore të Marrëveshjes për themelimin e Hapësirës Ekonomike Evropiane” janë shtetet anëtare të BE-së, Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia.

15) “shërbim me interes publik” është shërbimi i cili me ligj është përcaktuar se është veprimtari me interes publik;

16) “shkak i rrezikut të përgjithshëm dhe të veçantë” është gjendja e rrezikut që del drejtpërdrejtë nga kryerja e shërbimit të caktuar;

17) “shkaqe në lidhje me shëndetin dhe sigurinë” janë gjendjet kur mund të ndodh vdekja ose lëndimi serioz i pranuesit të shërbimit ose personit të tretë;

18) “shkaqe të sigurisë financiare” janë gjendjet në të cilat mund të vijë në humbjen evidente në para ose rënien e vlerës së pronës së pranuesit të shërbimit;

19) “sigurim nga përgjegjësia profesionale” është sigurimi që dhënësi i shërbimit e lidh për shkak të rastit të ndodhjes së ardhshme të gjendjes së përgjegjësive kundrejt pranuesve të shërbimeve dhe sipas nevojës kundrejt personave të tretë që dalin nga dhënia e shërbimeve;

20) “veprimtari multidisiplinare” është veprimtaria që dhënësi i shërbimeve mund lirisht të zgjedh nëse do ta kryejë së bashku me veprimtaritë tjera vetë ose në partneritet me personat tjerë.

II. PROCEDURAT PËR MIRATIM EDHE PIKA E VETME PËR KONTAKT

Thjeshtësimi i procedurave për miratim

Neni 5

(1) Në procedurën për miratimin e qasjes në tregun e shërbimeve organi kompetent i Republikës së Maqedonisë nuk do të kërkojë përmbushjen e sërishme të kërkesave të veçanta që janë të njëjta ose të ngjashme esenciale me kërkesat që dhënësi i shërbimit i ka përmbushur në Republikën e Maqedonisë në shtetin tjetër të HEE-së. Organi kompetent i Republikës së Maqedonisë nuk do të kërkojë dorëzimin e dokumentit në shtojcë të kërkesës në formë të kopjes së verifikuar në noter, të parashtrohet në origjinal, i përkthyer nga përkthyesi i autorizuar, përveç kur kjo kërkesë është pjesë e procedurës për shkaqe ekskluzivisht të rëndësishme për mbrojtjen e interesit publik, rendit publik dhe sigurisë. Organi kompetent i Republikës së Maqedonisë mund të kërkojë që dokumenti i cili jepet si shtojcë me kërkesën të përkthehet në gjuhën maqedonase.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohen për dokumentet që kërkohen me rregullat për furnizime publike, rregullat për njohjen e kualifikimeve profesionale, regjistrimi i të dhënave për shoqëritë e huaja tregtare dhe filialet e tyre në regjistrin tregtar në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare.

Pika e vetme e kontaktit

Neni 6

(1) Funksionin e pikës së vetme për kontakt në Republikën e Maqedonisë e kryen Portali nacional për shërbime që e zhvillohen, administrohen dhe mban Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës në pajtim me rregullat për menaxhim elektronik dhe shërbimet elektronike.

(2) Pika e vetme për kontakt personave të interesuar u siguron:

1) informata për procedurat dhe kushtet për qasjen dhe dhënien e shërbimeve,

2) plotësimin dhe parashtrimin e formularëve përkatës dhe fletëparaqitjeve të nevojshme për marrjen e pëlqimit nga organet kompetente të Republikës së Maqedonisë për qasjen dhe dhënien e shërbimeve, duke i përfshirë edhe fletëparaqitjet për regjistrim në regjistër, në katalog, bazën e të dhënave, ose për regjistrimin në shoqatën profesionale,

3) përgjigjen nga organet kompetente të Republikës së Maqedonisë për kërkesën e parashtruar për pëlqimin për qasjen dhe dhënien e shërbimeve.

(3) Informatat për procedurat dhe kushtet për qasjen dhe dhënien e shërbimeve nga paragrafi (2) të këtij neni duhet të jenë të qarta, të padykuptimta, lehtë të arritshme nga largësia si dhe në formë elektronike dhe rregullisht të azhurnohen.

(4) Dispozitat nga paragrafi (2) të këtij neni nuk zbatohen në procedurat në të cilat përfshihet veprimi i kontrollit të hapësirave në të cilat sigurohet shërbimi për shkak të inspeksionit të pajisjes konkrete që shfrytëzohet nga ana e dhënësit të shërbimit, ose kontrolli i drejtpërdrejtë (fizik) i shkathtësive të fituara ose integritetit personal të dhënësit të shërbimit ose personave të tij përgjegjës.

E drejta e informatave

Neni 7

(1) Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë kanë për detyrë përmes pikës së vetme për kontakt dhënësve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve t'u sigurojnë informata për:

1) procedurat ligjore për marrjen e pëlqimit të caktuar për qasjen dhe kryerjen e shërbimeve, me përshkrimin e procedurave ligjore dhe kërkesave që duhet të plotësohen;

2) organin kompetent për zbatimin e secilës procedurë të miratimit që ekziston në Republikën e Maqedonisë me adresën dhe informatat tjera të kontaktit për të;

3) mënyrën dhe kushtet për qasjen e personave të interesuar në të dhënat e regjistruar në regjistrat publikë për dhënësit e shërbimeve dhe për shërbimet si të tilla;

4) kundërshtimet, parashtrësat, ankesat, kontesti administrativ që i kanë në dispozicion palët e pakënaqur nga vendimi i organit kompetent në procedurat e miratimit me kërkesën për qasjen dhe kryerjen e shërbimeve dhe kontesteve që mund të paraqiten ndërmjet dhënësve të shërbimeve ose ndërmjet dhënësit dhe pranuesit të shërbimit;

5) kontaktin për shoqatat ose organizatat të cilat nuk janë organe kompetente, ndërsa nga të cilat dhënësit ose shfrytëzuesit e shërbimeve mund të marrin ndihmë praktike dhe

6) radhitjen e hapave sipas së cilave më shpesh kërkesa shqyrtohet dhe përpunohet në mënyrën e lehtë dhe të kuptueshme sipas mundësisë edhe në gjuhën zyrtare të shtetit të HEE-së, por jo si këshillë juridike, por në formë të informatës së përgjithshme për hapat në procedurë dhe mënyrën se si ato më shpesh zbatohen;

(2) Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë dhe Pika e vetme për kontakt kanë për detyrë në çdo kërkesë për informata nga paragrafi (1) të këtij neni të përgjigjen në afatin më të shkurtër të mundshëm, ndërsa në rastet kur kërkesa është e paplotësuar ose e pabazuar pa anulim ta njoftojnë kërkuesin për të.

III. LIRIA E THEMELIMIT TË DHËNËSVE TË SHËRBIMEVE

Liria e themelimit

Neni 8

(1) Qasja në tregun e shërbimeve dhe dhënia e shërbimeve në Republikën e Maqedonisë nuk kufizohet, përveç nëse me këtë ligj dhe me ligjet e veçanta ndryshe nuk përcaktohet.

(2) Me ligjet e veçanta nga paragrafi (1) të këtij neni përcaktohen procedurat për miratimin e qasjes në tregun e shërbimeve nëse shqyrtimi dhe vendimmarrja në to bëhet në pajtim me parimit e ndalimit të diskriminimit, trajtimit të barabartë, arsyeshmërisë së procedurës nga shkak i interesit publik dhe nëse qëllimi për shkak të cilit ekziston procedura nuk mund të plotësohet me masa më pak restriktive.

Parime për zbatimin e procedurave për miratimin e qasjes në tregun e shërbimeve

Neni 9

(1) Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë kanë për detyrë të miratojnë dhënien e shërbimeve në bazë të kërkesave të plotësuara në procedura përkatëse për miratimin e qasjes në tregun e shërbimeve të përcaktuara me ligj.

(2) Procedurat për miratimin e qasjes në tregun e shërbimeve zbatohen në pajtim me parimet si vijojnë:

- 1) ndalim i diskriminimit;
- 2) mbrojtje e interesit publik;
- 3) proporcionaliteti;
- 4) qartësia;
- 5) uniformitet i procedurës;
- 6) objektiviteti;
- 7) publikimi paraprak;
- 8) transparenca dhe
- 9) arritshmëria.

(3) Pëlqimi nga ana e organit kompetent të Republikës së Maqedonisë duhet t'i mundësojë dhënësit të shërbimit ta kryejë shërbimin nëpër gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, duke përfshirë përmes degëve, filialeve ose zyrave përveç në rastin kur kufizimi në aspekt të themelimit ose të territorit është i arsyeshëm nga shkaqe ekskluzivisht të rëndësishme me interes publik.

(4) Pëlqimi do të jepet pas shqyrtimit të kërkesës me provat e bashkëngjitura eventuale dhe pas konstatimit se janë përmbushur të gjitha kushtet për zgjidhjen pozitive për kërkesën nga ana e organit kompetent të Republikës së Maqedonisë.

(5) Çdo vendim i organeve kompetent të Republikës së Maqedonisë, duke përfshirë edhe refuzimin ose heqjen e pëlqimit kur nuk janë përmbushur ose tanimë nuk përmbushen kërkesat e veçanta, doemos duhet të përmbajnë arsyetim me këshillë juridike për të drejtën e kundërshtimit, ankesës përkatësisht ngritjes së kontestit administrativ ose mjetit tjetër juridik për mbrojtjen e të drejtave të tij në shkallë më të lartë.

Afati kohor i pëlqimit

Neni 10

(1) Pëlqimi i lëshuar nga ana e organit kompetent të Republikës së Maqedonisë nuk duhet të kufizohet në kohë përveç në rastet kur:

- 1) pëlqimi ripërtërihet me fuqinë e ligjit ose varet nga përmbushja e pandërprerë e të gjitha kërkesave të veçanta në procedurë;
- 2) numri i pëlqimeve është i kufizuar për shkaqe të interesit publik ose
- 3) periudha e kufizuar kohore për të cilën vlen pëlqimi është për shkaqe ekskluzivisht të rëndësishme me interes publik.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) të këtij neni nuk kanë të bëjnë me periudhën kohore maksimale në të cilën dhënësi doemos duhet të fillojë ta kryejë shërbimin pasi do ta marrë pëlqimin.

(3) Dhënësi i shërbimit do ta informojë organin kompetent të Republikës së Maqedonisë në rast kur:

- 1) regjistron degë aktivitetet e të cilave janë përfshirë në kornizat e shërbimit që dhënësi e kryen përmes tyre për çfarë i është dhënë pëlqimi;
- 2) kryen ndryshimin e statusit të tij juridik me çfarë ai nuk i përmbush kushtet për pëlqimin që paraprakisht i është lëshuar.

Zgjedhja e kërkuessit të cilit do t'i lëshohet pëlqimi në rast të numrit të kufizuar të pëlqimeve

Neni 11

(1) Kur në pajtim me rregullin e veçantë numri i pëlqimeve të arritshme për dhënien e shërbimit të caktuar është i kufizuar për shkaqe lidhur me kufizimin e resurseve natyrore ose kapacitetit të kufizuar teknik, organet kompetente të Republikës së Maqedonisë zbatojnë hapa në procedurë për miratim që garanton paanshmëri dhe transparencë dhe shpallje të detyrueshme paraprake publike për fillimin, zbatimin dhe mbarimin e procedurës së tillë.

(2) Në rastet e përcaktuara me paragrafin (1) të këtij neni, pëlqimi do të jepet për periudhë të caktuar kohore dhe nuk mund të jetë lëndë e vazhdimit me fuqinë e ligjit ose të përfshijë dhënien e përparësive tjera dhënësit të shërbimit pëlqimi i të cilit ka skaduar ose personit tjetër që ka lidhshmëri me të.

(3) Në përcaktimin e rregullave për zgjedhje në procedurat e miratimit në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe nenit 8 të këtij ligji, merren parasysh qëllimet e shëndetësisë publike, politikës sociale, shëndetit dhe sigurisë së të punësuarve ose personave të vetëpunësuar, mbrojtjes së mjedisit jetësor, mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe shkaqeve tjera ekskluzivisht të rëndësishme me interes publik.

Procedura për miratimin e qasjes në tregun e shërbimeve

Neni 12

(1) Procedura për miratimin e qasjes në tregun e shërbimeve duhet të jetë e qartë, paraprakisht e shpallur publikisht dhe e njëjta plotësisht duhet të japë siguri se kërkesat do të procesohen në mënyrë objektive dhe të paanshme.

(2) Procedura për miratimin e qasjes në tregun e shërbimeve së bashku me të gjitha shtojcat në kërkesë dhe formalitetet tjera nuk duhet të jetë e ndërlikuar dhe nuk duhet ta prolongojë fillimin e kryerjes së shërbimit për të cilën është përcaktuar. Kompensimi i cili duhet të paguhet nga kërkuessi duhet të jetë i arsyeshëm dhe proporcional me shpenzimin administrativ të organit kompetent të Republikës së Maqedonisë për mbajtjen e procedurës.

(3) Procedura për miratimin e qasjes në tregun e shërbimeve së bashku me të gjitha shtojcat duhet të përcaktohet në mënyrë që kërkesat e palëve procesohen më së shpejti që mundet, në periudhën e arsyeshme që është e pandryshueshme dhe paraprakisht i shpallur publikisht. Procedura do të rrjedhë nga momenti kur është dorëzuar gjithë dokumentacioni.

(4) Kur kjo është e arsyeshme për shkak të ndërlikueshmërisë së lëndës në çdo rast konkret, koha e përcaktuar mund të vazhdohet një herë, nga ana e organit kompetent të Republikës së Maqedonisë dhe vetëm për periudhë të caktuar. Për vazhdimin pala do të njoftohet para se të skadojë periudha për të cilën bëhet vazhdimi.

(5) Në rast organet kompetente të Republikës së Maqedonisë nuk i zbatojnë procedurat në mënyrën e përcaktuar në paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni do të konsiderohet se pëlqimi është dhënë, përveç kur me ligjet e veçanta janë përcaktuar kushte tjera për shkak të mbrojtjes së interesit publik ose interesit të arsyeshëm të personave të tretë.

(6) Të gjitha kërkesat për miratimin e qasjes në tregun e shërbimeve pranohen në shikim më së shpejti që mundet, e kjo përfshin:

1) vërtetimin për pranimin e kërkesës dhe afatin e përcaktuar për përgjigje nga organet kompetente të Republikës së Maqedonisë;

2) mënyrën e kontaktit të arritshëm për kërkuessin dhe

3) ku është e zbatueshme, deklarata se do të zbatohen dispozitat e ligjeve të veçanta dhe rregullave tjera që kanë të bëjnë me rastin kur nuk është dhënë përgjigje në afatin e caktuar pas kërkesës së parashtuar.

(7) Në rast të kërkesës së pakompletuar, pala do të njoftohet më së shpejti që mundet që ta plotësojë ose korrigjojë dokumentacionin.

(8) Kur kërkesa refuzohet sepse nuk është në pajtim me kërkesat e veçanta ose për shkak të veprimeve tjera hetimore, pala do të njoftohet për refuzimin më së shpejti që është e mundur.

Kërkesat e veçanta që nuk guxojnë t'i përmbajnë procedurat për miratim

Neni 13

Procedurat për miratimin e qasjes dhe dhënien e shërbimeve nuk guxojnë të përmbajnë kushte me të cilat organet kompetente të Republikës së Maqedonisë kërkojnë nga dhënësi i shërbimeve nga shtetet e HEE-së:

1) shtetësia e Republikës së Maqedonisë ose qëndrimi në territorin e Republikës së Maqedonisë e dhënësit të shërbimit, të punësuarve të tij, personave të cilët kanë pjesë në kryegjënë themelore të shoqërisë ose anëtarëve të organeve të menaxhimit dhe mbikëqyrjes, ndërsa në rast kur dhënësi i shërbimit është persn juridik, selia, zyra kryesore ose regjistri konkret i regjistrimit të subjektit në Republikën e Maqedonisë;

2) kufizimi i së drejtës së themelimit të degës, përfaqësisë, filialit ose njësisë tjetër organizative në më tepër se një shtet të HEE-së ose të regjistrimit në regjistrin kompetent konkret për kualifikimet profesionale në më tepër se një shtet të HEE-së;

3) kufizimi i së drejtës të zgjedhë ku do të regjistrohet si subjekt juridik ose ku do të hapë njësinë e vet organizative, si dhe zgjedhjes së formës së njësisë organizative si degë, përfaqësi ose filial;

4) reciprociteti me vendin në të cilin dhënësi i shërbimeve është regjistruar përveç në rast të reciprocitetit të përcaktuar për sferën e energjetikës;

5) paraprakisht të dëshmojë se ka nevojë ekonomike ose ka kërkesë në tregun për shërbime që do t'i kryejë, ose vlerësim të efekteve të ardhshme ekonomike ose efekteve ekonomike aktuale të shërbimit që ka për qëllim ta kryejë, ose vlerësim të përshtatshmërisë së veprimtarisë në lidhje me qëllimet e planifikuara ekonomike nga ana e organeve kompetente me përjashtim të atyre që bazohen në interesin publik dhe janë proporcionale;

6) drejtpërdrejt ose tërthorazi nuk do të përfshijë operatorë ekonomikë të cilët në tregun e shërbimeve do t'i jenë konkurrentë dhënësit të shërbimit që ka parashtruar kërkesë për qasjen në treg me dhënien e mendimeve në procedurën e miratimit ose gjatë miratimit të vendimit nga organet dhe trupat kompetente, me përjashtim të trupave dhe shoqatave profesionale ose organizatave tjera që veprojnë si bartës të autorizimeve publike;

7) të japë ose të marrë pjesë në dhënien e garancisë financiare ose siguri tjetër që duhet të lëshohet nga personi juridik i themeluar në Republikën e Maqedonisë, me përjashtim të fondeve të përbashkëta të kompensimit, trupave ose organizatave profesionale;

8) obligim për regjistrim paraprak në regjistrin kompetent të Republikës së Maqedonisë në ndonjë periudhë të caktuar kohore ose për kryerjen paraprake të shërbimit në Republikën e Maqedonisë në ndonjë periudhë të caktuar kohore.

IV. LIRIA E DHËNIES SË SHËRBIMEVE DHE KUFIZIME

Liria e qasjes dhe dhënies së shërbimeve

Neni 14

(1) Dhënësit e shërbimeve të themeluar në Republikën e Maqedonisë dhe në shtete të HEE-së kanë qasje të lirë në tregun e shërbimeve në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me kërkesat e përcaktuara në ligje dhe rregulla të veçanta me të cilat rregullohen shërbimet.

(2) Gjatë përcaktimit të kërkesave nga paragrafi (1) i këtij neni doemos duhet të respektohen principet vijuese:

1) ndalim i diskriminimit: kërkesat nuk guxojnë të diskriminojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në lidhje me shtetësinë ose në rast të personave juridikë në lidhje me vendin në të cilin janë themeluar;

2) domosdoshmëri: kërkesat doemos duhet të arsyetohen për shkaqe lidhur me politikën publike, sigurinë publike, shëndetin publik ose mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe

3) proporcionalitet: kërkesat doemos duhet të jenë adekuate për arritjen e qëllimit për të cilin janë përcaktuar, si dhe rregullat për marrëdhënie pune dhe dispozitat nga marrëveshjet kolektive.

(3) Qasja në tregun e shërbimeve në procedurat e miratimit për dhënës të shërbimeve të themeluara në shtetet e HEE-së nuk mund të jetë e kufizuar me:

1) obligim për themelim në Republikën e Maqedonisë;

2) obligim për të marrë pëlqim nga organi kompetent në Republikën e Maqedonisë, siç është regjistrimi në regjistrin vendor përveç nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar më ndryshe;

3) ndalim për dhënësit e shërbimeve për të vendosur lloj ose tip të caktuar të infrastrukturës në Republikën e Maqedonisë që të mund t'i japë shërbimet;

4) zbatim i përmbytjes së përcaktuar të marrëveshjeve me pranuesit e shërbimeve me të cilat pengohet ose kufizohet dhënia e shërbimeve nga ana e personit të vetëpunësuar;

5) obligim për të poseduar dokumente për identifikim të lëshuara nga organe kompetente në Republikën e Maqedonisë që të japë shërbime;

6) kërkesat, përveç atyre që janë të domosdoshme për shëndetin dhe sigurinë e vendit të punës, që ndikojnë në përdorimin e pajisjes dhe materialeve që janë pjesë përbërëse të shërbimit dhe

7) kufizime të përcaktuara me nenin 17 të këtij ligji.

Kufizimet e lirisë së kryerjes së shërbimeve

Neni 15

Dispozitat e nenit 14 nuk zbatohen për:

1) shërbimet me interes publik nga sferat e sektorit postar, energjetik dhe gazsjellës,

2) furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të zeza urbane, dhe veprimin me mbeturina;

3) dispozitat për punë të punëtorëve të zhvendosur lidhur me lëvizjen e lirë të punëtorëve për shkak të kryerjes së punës dhe realizimit të të drejtave nga marrëdhënia e punës në shtete tjera të BE-së dhe HEE-së;

4) dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale;

5) përmbytje gjyqësore të borxhit;

6) raste ku me ligj të veçantë një shërbim është përcaktuar që të kryhet vetëm në bazë të kualifikimit të fituar profesional;

7) dispozitat nga sfera e sigurimit social lidhur me koordinimin e sistemeve të sigurimit social të personave të punësuar, personave të vetëpunësuar dhe anëtarëve të familjeve të tyre;

8) procedurat administrative për lëvizje të lirë të personave dhe qëndrim të tyre të përhershëm ose të përkohshëm;

9) dispozitat lidhur me dhënien e vizave ose lejeve për qëndrim të personave nga vendet e treta;

10) rregullat lidhur me transportin e hedhurinave;

11) të drejtat autoriale dhe të ngjashme, të drejtat nga pronësia industriale dhe nga sferat e mbrojtjes së topografëve të prodhimeve - gjysmëpërçues dhe nga sfera e mbrojtjes së bazave të të dhënave;

12) aktet të cilat në pajtim me ligjin kërkojnë verifikim në noter;

- 13) revizionin e llogarive vjetore dhe raporteve financiare;
- 14) regjistrimin e automjeteve të blera me lizing në shtete tjera nga BE-ja ose HEE-së dhe
- 15) obligimet kontraktuese dhe jashtëkontraktuese përfshirë edhe marrëveshjet formale të përcaktuara në bazë të rregullave të së Drejtës private ndërkombëtare.

Kufizime në raste të jashtëzakonshme

Neni 16

Me përjashtim të dispozitave nga neni 14 i këtij ligji organet kompetente të Republikës së Maqedonisë mund të ndërmarrin masa për kufizim të lirisë së dhënies së shërbimeve të themeluara në shtetin e HEE-së për mbrojtjen e sigurisë së shërbimeve, nëse procedura e bashkëpunimit të ndërsjellë të rregulluar me nenin 30 të këtij ligji është zbatuar në mënyrë përkatëse dhe janë përmbushur kushtet në vijim:

- 1) dispozitat për shkak të të cilave ndërmerret masa nuk janë përfshirë me rregullat për siguri të shërbimeve;
- 2) masat japin shkallë më të lartë të mbrojtjes së pranuesit të shërbimit sesa cilido rast i mbrojtjes në vendi në të cilin kryerësi i shërbimit është regjistruar;
- 3) vendi ku është themeluar kryerësi nuk ka ndërmarrë masa në pajtim me paragrafin (1) neni 30 i këtij ligji dhe
- 4) masat janë proporcionale me qëllimin lidhur me sigurinë e shërbimeve.

V. TË DREJTAT E PRANUESVE TË SHËRBIMEVE

Kufizime të ndaluara ndaj pranuesve të shërbimeve

Neni 17

Pranuesi i shërbimeve në Republikën e Maqedonisë i cili shfrytëzon shërbim nga ana e dhënësit të shërbimit nga shtet tjetër i HEE-së nuk ka për obligim:

- 1) të marrë pëlqim ose t'i japë deklaratë organit kompetent të Republikës së Maqedonisë në lidhje me shërbimin dhe
- 2) t'u nënshtrohet kufizimeve diskriminuese të dhënies së ndihmës financiare për arsye se dhënësi i shërbimit ka themeluar seli në shtet tjetër të HEE-së ose për shkak vendit në të cilin është dhënë shërbimi.

Ndalimi i diskriminimit

Neni 18

(1) Pranuesi i shërbimeve ka të drejtë që t'i pranojë shërbimet lirshëm dhe pa kufizime lidhur me shtetësinë ose vendqëndrimin e tij.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet edhe për kushtet e përgjithshme për qasje në shërbimet të cilat dhënësi i shërbimeve publikisht i shpall dhe të njëjtat nuk duhet të përmbajnë kufizime në lidhje me shtetësinë ose vendqëndrimin përveç kur lëshimet objektivisht dalin nga kushtet e ndryshme tregtare në vende.

Ndihma e pranuesve të shërbimeve

Neni 19

(1) Pranuesit e shërbimeve në Republikën e Maqedonisë nga çdo organ kompetent i Republikës së Maqedonisë dhe nëpërmjet Pikës së vetme për kontakt mund të marrë:

- 1) informatat e përgjithshme për qasje në shërbimet në shtetet tjera nga HEE.

2) informatat e përgjithshme për mënyrat për kompensim të dëmit të cilat i kanë në dispozicion dhe

3) kontaktet nga shoqatat e ndryshme, përfshirë edhe nga BE-ja si Rrjeti evropian i qendrave për mbrojtje të konsumatorëve, nga të cilat pranuesit e shërbimeve mund të marrin ndihmë praktike.

(2) Të gjitha informatat dhe ndihma këshillëdhënëse nga organi kompetent përfshirë edhe udhëzimet për çdo fazë në procedurën deri te të cilat pranuesit e shërbimeve duhet t'u përmbahen jepen në mënyrë të qartë edhe në formë elektronike.

Informatat të cilat dhënësi i shërbimeve duhet t'i bëjë të disponueshme për pranuesit e shërbimeve

Neni 20

(1) Dhënësi i shërbimeve në Republikën e Maqedonisë është i detyruar t'i bëjë të disponueshme për pranuesit e shërbimeve të dhënat dhe informatat në vijim:

1) emri dhe mbiemri, përkatësisht firma dhe statusi juridik, vendbanimi përkatësisht selia ku është regjistruar, dhe informatat kontaktuese përfshirë edhe mënyrën e komunikimit elektronik (ueb aplikimi dhe/ose posta elektronike);

2) titulli i regjistrimit, numri i regjistrimit (numri i regjistrimit/numri identifikues) kur dhënësi i shërbimit është regjistruar në regjistër tregtar ose të ngjashëm dhe shteti ku gjendet regjistri;

3) informatat edhe për atë se nga organ kompetent ka marrë pëlqim për dhënie të shërbimeve në shtetin në të cilin është themeluar përkatësisht është shtetas;

4) numri tatimor në regjistrin tatimor në vend në të cilin mbahet, ose numër tjetër identifikimi dhe titulli i organit ose trupi ku është pranuar përkatësisht regjistruar kualifikimi i tij profesional nëse ajo është e detyruar;

5) informatat e përgjithshme dhe klauzolat të cilat i zbaton dhënësi i shërbimit;

6) klauzolat kontraktuese nëse ka të tilla në lidhje me të drejtën e cila zbatohet në aranzhmanet e tij kontraktuese me pranuesit e shërbimeve ose në rast të kontestit për të drejtën/rregullat e gjykatës kompetente ose arbitrazhi;

7) garancitë që i jep dhënësi pasi do ta kryejë shërbimin ndaj pranuesit;

8) çmimi i shërbimeve të cilat i jep në rastet kur ai është përcaktuar paraprakisht për lloj përkatës të shërbimeve;

9) veçoritë e shërbimit të cilin e kryen përveç nëse ai nuk është vetvetiu i dukshëm dhe

10) sigurimi ose garancia të cilave u referohet neni 21 paragrafi (2) të këtij ligji, ndërsa veçanërisht informatat kontaktuese për siguruesin ose garantin si dhe mbulimin territorial.

(2) Dhënësi i shërbimeve është i detyruar që të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni t'ia bëjë të disponueshme pranuesit të shërbimit, në vendin ku do të kryhet shërbimi, në formë elektronike dhe me detajet, në vendin ku do të kryhet shërbimi, në formë elektronike dhe me detaje për përshkrimin e shërbimit që e jep.

(3) Me kërkesë të pranuesit të shërbimit dhënësit e shërbimeve janë të detyruar që t'i bëjnë të disponueshme informatat plotësuese vijuese:

1) nëse çmimi i shërbimit nuk është përcaktuar paraprakisht nga dhënësi i shërbimit për llojin e caktuar të shërbimit atëherë duhet të bëhet i disponueshëm çmimi i rregullt ose mënyra në të cilën ai përllongaritet që të mund i shërbejë pranuesit;

2) rregullat me të cilat rregullohet kualifikimi profesional në fjalë dhe si ai fitohet;

3) informatat për aktivitetet multidisiplinare dhe partneritetet të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë me shërbimin konkret dhe për masat të cilat janë ndërmarrë që të shmangët konflikti i interesit. Këto informata mund të përmbahen në të gjitha materialet ose dokumentet në të cilat përshkruhet nga dhënësi i shërbimit;

4) kodi i sjelljes të cilit i përmbahet dhënësi i shërbimit dhe ueb faqja ku ato janë të disponueshme në formë elektronike me shenjë për gjuhën në të cilën janë shkruar dhe

5) në rast kur dhënësi i shërbimit vepron në pajtim me kodin, ose është anëtar i shoqërisë tregtare ose odës ose trupit profesional i cili jep shërbime për zgjidhje të kontesteve jashtëgjyqësore, nevojitet që të jepen informata edhe për atë se çfarë janë procedurat, rastet dhe mënyra në të cilën shfrytëzohet mundësia e tillë për mbrojtjen e të drejtave të pranuesit.

(4) Të gjitha informatat dhe të dhënat të cilat në pajtim me dispozitat e këtij neni dhënësi duhet t'i bëjë të disponueshme para se të lidhet marrëveshja konkrete nga dhënësi i shërbimeve, përkatësisht para se i njëjti ta japë shërbimin.

(5) Dhënësit e shërbimeve janë të detyruar që në afat më të shkurtër që mund t'u përgjigjen pranuesve të shërbimeve të tyre dhe t'u japin informata të vërteta dhe të përdorshme pranuesve, në lidhje me të gjitha aspektet lidhur me shfrytëzimin e shërbimeve të tyre.

(6) Në rast kur kërkohen garanci financiare në procedurën e përcaktuar me ligj para organeve kompetente të Republikës së Maqedonisë, garancitë e lëshuara nga institucioni përkatës kreditor ose i sigurimit i autorizuar në vend ose në shtetin e HEE të japë garanci të tilla, duhet të pranohen si dëshmi.

(7) Dhënësit e shërbimeve të cilët veprojnë gjatë kryerjes së veprimtarisë në pajtim me rregullat e përcaktuara në udhëzimet ose aktet përkatëse ose janë anëtarë të shoqërive ekonomike përkatëse ose trupa profesionale që japin mundësi për angazhimin e mekanizmit gjyqësor për zgjidhjen e kontesteve janë të detyruar që ta informojnë pranuesin e shërbimit për mundësinë e tillë dhe ta cekin atë të dhënë në çdo dokument në të cilin sqarohet shërbimi i tyre në detaje, duke shënuar si të merret qasje në ato informata.

Sigurimi dhe garancitë për përgjegjësi profesionale të dhënësit të shërbimeve

Neni 21

(1) Kur shërbime të caktuara kryerja e të cilëve mund të shënojnë rrezik për shëndetin ose sigurinë e pranuesit të shërbimit ose personit të tretë, ose rrezik për sigurinë financiare të pranuesit të shërbimit, dhënësi i shërbimeve i themeluar në Republikën e Maqedonisë doemos duhet të sigurojë sigurim nga përgjegjësia profesionale ose garanci tjetër me vlerë të njëjtë adekuate me qëllimin e saj e cila do ta mbulojë rrezikun e shërbimit.

(2) Organi kompetent i Republikës së Maqedonisë nuk kërkon sigurim, garanci ose dokument tjetër si mjet për sigurimin e dhënësit të shërbimit i cili veprimtarinë e ushtron në Republikën e Maqedonisë, nëse në vendin në të cilin ka vendbanim përkatësisht seli atë tanimë e ka përmbushur, as të lidhë aranzhmane kontraktuese për sigurim nga përgjegjësia profesionale ose lloj tjetër i garancisë nëse paraqet vërtetim për sigurimin ose garancinë e tillë e cila është me vlerë të njëjtë të lëshuara nga institucione të autorizuar financiare ose shoqëri sigurimi me seli në vendin ku është themeluar. Kur ekuivalenca garancisë është vetëm e pjesshëm, organet kompetente të Republikës së Maqedonisë mund të kërkojnë garanci plotësuese për rreziqet të cilat nuk janë mbuluar.

Komunikime komerciale te profesionete rregulluara

Neni 22

(1) Komunikimet komerciale të dhënësve të shërbimeve që kryejnë profesione të rregulluara kryhen në pajtim me rregullat për profesionin e rregulluar konkret, e në bazë të respektimit të pavarësisë, dinjitetit dhe autoritetit të profesionit dhe ruajtjes së sekretit profesional duke e pasur parasysh natyrën e çdo profesioni konkret të rregulluar.

(2) Kufizime të përmbajtjes së komunikimit komercial nga paragrafi (1) i këtij neni mund të futen vetëm në bazë të respektimit të principeve të mosdiskriminimit, proporcionalizimit dhe arsytimit për arsye të jashtëzakonshme për mbrojtjen e interesit publik.

Veprimtaritë multidisiplinare

Neni 23

(1) Dhënësit e shërbimeve mund të kryejnë më shumë se një lloj të shërbimeve (veprimtari multidisiplinare), në mënyrë të mëvetësishme ose në partneritet, me përjashtim të:

1) profesionet e rregulluara, në pajtim me kushtet e arsyetuara për shkak të harmonizimit me rregullat që rregullojnë etikë profesionale dhe sjellje, ndërsa dallohen duke pasur parasysh natyrën specifike të çdo profesioni dhe nëse kushtet e tilla janë të nevojshme që të sigurohet pavarësia e tyre ose paanshmëria e tyre dhe

2) dhënësit e shërbimeve nga sfera e certifikimit, akreditimit, mbikëqyrja teknike, testimi ose eksperimentet, nëse kushtet e tilla janë të nevojshme për sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së tyre.

(2) Kur për kryerjen e veprimtarisë multidisiplinare nga dhënësit e shërbimit të cekura në pikat 1) dhe 2) nga paragrafi (1) të këtij neni jepet pëlqim, nevojitet që të:

1) pengohet konflikti i interesave dhe pabarazitë ndërmjet veprimtarive të caktuara multidisiplinore;

2) sigurohet pavarësi dhe paanshmëri në kryerjen e tyre dhe

3) harmonizohen rregullat të cilat e rregullojnë etikën profesionale dhe sjelljen, veçanërisht në lidhje me pjesën e cila ka të bëjë me sekretin profesional.

VI. BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV

Bashkëpunimi i ndërsjellë administrativ me shtetet e HEE dhe me Komisionin Evropian

Neni 24

(1) Organet kompetente nga Republika e Maqedonisë do të marrin pjesë në këmbimin e informatave me organet kompetente të shteteve nga HEE nëpërmjet sistemit IMI.

(2) Për qëllimet e IMI sistemit dhe për zbatimin e këtij ligji me propozim të Ministrisë së Ekonomisë Qeveria e Republikës së Maqedonisë emëron:

1) Koordinator nacional IMI dhe

2) Koordinator/ë për shërbime

(3) Koordinatorin nacional IMI nga paragrafi (2) pika 1) të këtij neni është nga radhët e nëpunësve administrativë udhëheqës të punësuar në Ministrinë e Ekonomisë, ndërsa koordinatorët për shërbime nga paragrafi (2) pika 2) të këtij neni janë nga radhët e të punësuarve në ministritë me kompetencë për sektorët e shërbimit të përfshirë me këtë ligj.

(4) Fushëveprimi i punës për qëllimet e IMI sistemit të personave nga paragrafi (2) pikat 1) dhe 2) të këtij neni dhe procedura për këmbimin e informatave nëpërmjet sistemit IMI i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(5) Ministria e Ekonomisë publikon Listë të organeve kompetente nga Republika e Maqedonisë nga paragrafi (1) i këtij neni në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(6) Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë janë të detyruar që të ndërmarrin masa për bashkëpunim me organe kompetente nga shtete nga HEE për kontroll të dhënësve të shërbimeve dhe shërbimeve që përfshijnë kërkesë për informatat ose për kontrollet.

(7) Kërkesat për informatën ose për kontrollët të cilat dorëzohen nga organet kompetente nga shtetet nga HEE në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë doemos duhet të arsyetohen me shkaqe për të cilat janë parashtruar dhe të gjitha informatat e grumbulluara do të shfrytëzohen veçanërisht për nevojat për të cilat janë kërkuar.

(8) Në rast kur ka vështirësi në veprimin me kërkesë të organit kompetent të shtetit nga HEE, organi kompetent nga Republika e Maqedonisë do të hyjë në kontakt të drejtpërdrejtë me organin kompetent nga shteti nga HEE në drejtim të gjetjes së zgjidhjes për lëndën konkrete.

(9) Në rast kur është marrë kërkesë për ndihmë nga organet kompetente nga HEE, organi kompetent nga Republika e Maqedonisë ka të drejtë të kërkojë nga kryerësi i shërbimit në Republikën e Maqedonisë t'i dorëzojë për shkak të kontrollit të të gjitha të dhënave të nevojshme në pajtim me ligjet e veçanta.

(10) Për rezultatet nga veprimi për kërkesat, organet kompetente në Republikën e Maqedonisë në formë elektronike, në afatin më të shkurtër të mundshëm do t'i informojnë organet kompetente të shteteve nga HEE të cilat i kanë dorëzuar kërkesat.

(11) Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë janë të detyruara që të sigurojnë hyrje të pandërprerë dhe shfrytëzim të të dhënave për dhënësit e shërbimeve për organet kompetente nga shtete nga HEE dhe të japin ndihmë teknike për shfrytëzimin e të dhënave nga regjistrat të cilat mbahen te organet dhe institucionet tjerë, e për të cilat shtetet nga HEE kanë nevojë që të marrin informata.

(12) Koordinatori nacional IMI është i detyruar që ta njoftojë Komisionin Evropian për çdo rast të veçantë për të cilin është dorëzuar kërkesë e arsyetuar nga organi kompetent në Republikën e Maqedonisë, e për të cilin organ kompetent nga shteti i HEE nuk ka vepruar.

Bashkëpunimi i ndërsjellë në rast kur dhënësi i shërbimeve nga Republika e Maqedonisë kryejnë shërbime në shtet tjetër nga BE dhe HEE

Neni 25

(1) Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë janë të detyruara që në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë të veprojnë për çdo kërkesë nga shteti tjetër nga HEE dhe të dorëzojnë informata për dhënësit e shërbimeve nëpërmjet sistemit IMI në afatin më të shkurtër të mundshëm, e veçanërisht për atë nëse dhënësi i shërbimeve është regjistruar në regjistër kompetent dhe nëse punon në pajtim me rregullat ligjore të Republikës së Maqedonisë.

(2) Organi kompetent i Republikës së Maqedonisë kryen kontrole, mbikëqyrje inspektuese në pajtim me kompetencat e veta dhe nëpërmjet sistemit IMI i informon organet kompetente nga shteti nga HEE për rezultatet dhe masat e ndërmarra. Për t'iu përgjigjur kërkesave të dorëzuara nga paragrafi (1) i këtij neni për çdo rast konkret do të zbatohen masa adekuate të përcaktuara në ligjet e veçanta.

Mbikëqyrja mbi dhënësin e shërbimeve me seli në Republikën e Maqedonisë i cili i kryen përkohësisht shërbimet në shtet tjetër të HEE-së

Neni 26

(1) Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë realizojnë mbikëqyrje mbi dhënësit e shërbimeve të themeluar në Republikën e Maqedonisë për përmbushjen e dispozitave ligjore në lidhje me kryerjen e shërbimit në pajtim me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë dhe ndërmarrin masa të nevojshme pa marrë parasysh nëse shërbimi kryhet përkatësisht shkakton pasoja në Republikën e Maqedonisë ose në shtet tjetër të HEE-së.

(2) Ndërmarrja e masave në pajtim me dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni nuk i obligon organet kompetente të Republikës së Maqedonisë që të kryejnë kontrolle faktike, inspeksione ose hetime në shtetin e HEE-së ku është kryer shërbimi. Këto veprime do të kryhen nga organet kompetente të shtetit nga HEE në pajtim me rregullat e tij nacionale.

Mbikëqyrja e dhënësit të shërbimeve nga shteti tjetër i HEE-së kur i njëjti kryen shërbime në Republikën e Maqedonisë

Neni 27

(1) Organi kompetent i Republikës së Maqedonisë kryen mbikëqyrje mbi aktivitetet e ofruesit të shërbimeve nga një shtet tjetër nga HEE, i cili në baza të përkohshme kryen shërbimin në Republikën e Maqedonisë, në përputhje me kërkesat për qasje dhe kryerjen e shërbimit nga nenet 14 dhe 15 të këtij ligji.

(2) Organi kompetent i Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të organit kompetent të një shteti tjetër të HEE-së, ku është themeluar ofruesi i shërbimit që kryen shërbimin e përkohshëm në Republikën e Maqedonisë kryen kontrolle, inspektime dhe hetime, në suaza të autorizimeve të tij ligjore për të arritur qëllimin e kërkesës dhe me zbatimin e masave më të përshtatshme për secilin rast të veçantë.

(3) Kontrollat, inspektimet dhe hetimet e kryera në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni duhet të jenë proporcionale dhe jo diskriminuese në lidhje me përkatësinë e ofruesit të shërbimeve me një vend tjetër të HEE-së.

Mekanizmi për paralajmërim

Neni 28

(1) Kur organi kompetent i Republikës së Maqedonisë ka njohuri për aktet, veprimet ose gjendjet lidhur me kryerjen e shërbimit që mund të shkaktojnë dëmtim të shëndetit ose sigurisë së personave ose të mjedisit jetësor, është i obliguar t'i njoftojë nëpërmjet sistemit IMI të gjitha vendet e HEE-së dhe Komisionin Evropian në afat sa më të shkurtër.

(2) Procedurën e informimit nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i Ekonomisë.

Informata për autoritet të mirë të dhënësve të shërbimeve

Neni 29

(1) Me kërkesën e organit kompetent nga shteti i HEE-së, organi kompetent i Republikës së Maqedonisë, në përputhje me ligjet e veçanta në Republikën e Maqedonisë dorëzon informacion për sanksionet e shqiptuara për kundërvajtje ose sanksionet penale të ofruesit të shërbimeve, qoftë në falimentim ose likuidim, nëse i është shqiptuar masë për ndalim për kryerjen e veprimtarisë dhe nëse punon në përputhje me kornizën ligjore për kualifikimet profesionale nëse është kështu, për të cilin e njofton ofruesin e shërbimit. Kërkesa duhet të përmbajë shkaqet për arsye të cilave është dorëzuar

(2) Për sanksionet ose masat e tjera të shqiptuara nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të njoftohen vetëm nëse është marrë vendim përfundimtar. Nëse është në procedurë të shkallës së dytë për shqyrtim dhe vendimarrje, duhet të informohet për datën kur pritet vendimi për kundërshtimin e paraqitur. Organi kompetent i Republikës së Maqedonisë i përcakton dispozitat e ligjeve të veçanta në pajtim me të cilat janë marrë masat dhe sanksionet për ofruesin e shërbimit.

(3) Të gjitha informacionet e shkëmbyera në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë shkëmbehen në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë.

Bashkëpunimi i ndërsjellë në raste të mënjanimi në raste konkrete

Neni 30

(1) Kur në rastin e përcaktuar në nenin 16 të këtij ligji me ligjet e veçanta jepet autorizim për marrjen e masave për mbrojtjen e sigurisë në ofrimin e shërbimeve, organet kompetente të Republikës së Maqedonisë janë të detyruara të paraqesin kërkesë tek organet kompetente të shtetit të HEE-së, ku ofruesi i shërbimeve bazohet, të ndërmarrin veprime të caktuara nën juridiksionin e tyre dhe t'i dorëzojnë të dhënat me të cilat disponojnë për rastin konkret.

(2) Në bazë të komunikimit të realizuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, si dhe veprimeve të njëpasnjëshme të ndërmarra nga organet kompetente në shtet të HEE-së në të cilin është bazuar ofruesi i shërbimeve, organi kompetent i Republikës së Maqedonisë mund të kërkojë që koordinatori kombëtar IMI ta informojë Komisionin Evropian për arsyet përse vlerëson se masat e marra nga organi kompetent i shtetit të HEE-së ose arsyet për masat e pandërmarra janë të paplota, joefektive ndaj qëllimeve që duhen arritur.

(3) Kur aktivitetet e përcaktuara në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni i referohen ofruesve të shërbimeve nga Republika e Maqedonisë, organet kompetente të Republikës së Maqedonisë janë të detyruara, sa më shpejt që të jetë e mundur, të ndërmarrin masa që janë propozuar ose të njoftojnë për arsyet pse nuk kanë ndërmarrë ndonjë nga masat e kërkuara.

(4) Afati për marrjen e masave nga organet kompetente të Republikës së Maqedonisë, respektivisht afati për marrjen e masave nga organet kompetente dhe trupat e shteteve të HEE-së, në përputhje me dispozitat e këtij neni, është 15 ditë pune nga dita kur Komisioni Evropian është njoftuar për pamjaftueshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra nga organi i Republikës së Maqedonisë ose nga një shtet i HEE-së. Masat nuk do të merren nëse Komisioni Evropian konkludon se ato janë joadekuate dhe merr vendim me çka kërkon nga organet kompetente të Republikës së Maqedonisë të abstenojnë nga masat ose të pezullojnë kërkesën.

(5) Në rast të nevojës për të marrë masa urgjente për të mbrojtur sigurinë e ofrimit të shërbimeve, organet kompetente të Republikës së Maqedonisë mund të përjashtojnë procedurën e theksuar në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nëse paraprakisht e njoftojnë Komisionin Evropian dhe shtetin e HEE-së në të cilin është themeluar ofruesi i shërbimeve, në afat sa më të shkurtër dhe me theksimin e arsyeve për të njëjtën

VII.MBIKËQYRJA

Mbikëqyrja

Neni 31

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji kryen Ministria e Ekonomisë.

(2) Në zbatimin e mbikëqyrjes mbi këtë ligj Ministria e Ekonomisë:

1) e përcjell dhe koordinon të gjithë procesin e harmonizimit dhe miratimit me kohë të ligjeve të veçanta me dispozitat e këtij ligji;

2) e përcjell zbatimin e këtij ligji si dhe rregullat që dalin prej tij dhe

3) informon dhe u sugjeron organeve kompetente të Republikës së Maqedonisë për përcaktimin e parregullsive gjatë zbatimit të dispozitave të këtij ligji me çka jep mendime dhe rekomandime dhe propozon masa me qëllim që ato të eliminohen.

Mbikëqyrja inspektuese

Neni 32

(1) Mbikëqyrje inspektuese për zbatimin e dispozitave të nenit 20 të këtij ligji, kryen Inspektorati Shtetëror i Tregut nëpërmjet inspektorëve në pajtim me dispozitat e Ligjit për Inspektoratin e Tregut dhe këtij Ligji.

(2) Në zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, Inspektorati Shtetëror i Tregut do të:

1) përcjellë nëse ofruesi i shërbimeve ka bërë të qasshme për pranuesin e shërbimeve të dhënat dhe informacionin e theksuara në nenin 20, paragrafi (1) dhe informatat shtesë të theksuara në nenin 20 paragrafin (3) të këtij ligji.

2) përcjell nëse ofruesi i shërbimeve ka vënë në dispozicion informatat në vendin ku kryhet shërbimi, disponueshmërinë e tyre në mënyrë elektronike dhe nëse të gjitha detajet janë dhënë për përshkrimin e shërbimit që ofrohet.

3) përcjell nëse informatat janë të qarta, të kuptueshme dhe të disponueshme për marrësin e shërbimeve para lidhjes së marrëveshjes dhe para përfundimit të shërbimit.

4) përcjell nëse ofruesi i shërbimeve u përgjigjet kërkesave të marrësit të shërbimeve dhe u jep atyre ndihmë adekuate dhe nëse u përgjigjet nevojave të marrësve në kohën më të shkurtër të mundshme dhe me resurse adekuate njerëzore.

VIII. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 33

(1) Për kundërvajtjet e parapara me këtë ligj, kryhet procedurë kundërvajtëse dhe shqiptohet dënim me kundërvajtje nga gjykata kompetente.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 34 të këtij ligji, inspektori i tregut shtetëror është i obliguar t'i propozojë kryerësit të kundërvajtjes një procedurë të zgjidhjes para paraqitjes së kërkesës për kundërvajtje para gjykatës kompetente në pajtim me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

Neni 34

(1) Gjobë në shumë prej 1000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit ofrues i shërbimit, i cili:

1) nuk ia bën informacionin në dispozicion marrësit të shërbimeve në përputhje me dispozitat e nenit 20 paragrafit (1) të këtij ligji.

2) nuk i përgjigjet kërkesës së marrësit të shërbimit në përputhje me dispozitat e nenit 20 paragrafit (3) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në person juridik për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik që kryen shërbimin për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.

IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 35

(1) Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë janë të obliguara, brenda një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të informojnë Ministrinë e Ekonomisë për të gjitha dispozitat në rregullat që përmbajnë kërkesa për ofruesit e shërbimeve në lidhje me e qasjen dhe kryerjen e shërbimeve / veprimtarive të shërbimit për të cilat do të përcaktohet se janë:

1) me përkufizime kualitative ose territoriale, në veçanti në formën e kufizimeve fikse në bazë të numrit të popullsisë ose distancës gjeografike minimale midis ofruesve të shërbimeve;

2) me obligim ofruesi i shërbimeve të përdorë formë të veçantë juridike;

3) me kërkesat lidhur me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë tregtare;

4) me kërkesa me të cilat sigurohet qasje në shërbim për ofruesit e veçantë të shërbimeve në bazë të natyrës së veçantë të shërbimit;

5) me ndalim të hapet më shumë se një njësi organizative në Republikën e Maqedonisë;

- 6) me numër minimal të përcaktuar të punonjësve nga ofruesi i shërbimeve;
- 7) me tarifa minimale ose maksimale të përcaktuara për pagimin e kompensimeve nga ofruesi i shërbimeve dhe
- 8) me obligim të ofruesit të shërbimeve të sigurojë shërbime të tjera së bashku me shërbimet që i ofron ai.

(2) Në njoftimin nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të theksohet arsytim për shkaqet e kërkesave dhe nëse ato janë në përputhje me parimet e:

1) diskriminimit në bazë të shtetësisë ose përkatësisë së personave ose në rastin e personave juridikë në bazë të vendit në të cilin janë themeluar;

2) domosdoshmërisë së kërkesave individuale të justifikuara për arsye jashtëzakonisht të rëndësishme me interes publik dhe

3) proporcionalitetit të kërkesave individuale për përshtatshmërinë e tyre për arritjen e qëllimeve, respektivisht të mos e tejkalojnë nevojën për arritjen e qëllimit dhe si i tillë nuk mund të zëvendësohen me kërkesa të tjera individuale, më pak kufizuese që arrijnë të njëjtin rezultat.

(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni zbatohen për rregullat që rregullojnë shërbimet me interes publik vetëm nëse zbatimi i tyre nuk e pengon qëllimin e tyre në përputhje me ligjin.

(4) Çdo organ kompetent i Republikës së Maqedonisë është i obliguar të njoftojë me shkrim Ministrinë e Ekonomisë nëse në përputhje me dispozitat e paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni ka kërkesë individuale të cilat i konsideron të nevojshme që të mbahen në ligjet e veçanta me arsytim për shkaqet për të cilat vlerëson se të njëjtit janë në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni dhe gjithashtu ta informojnë për dispozitat që do të shfuqizohen.

(5) Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë nuk do të vendosin kërkesa të reja nga paragrafi (1) i këtij neni nëse nuk i përmbushin parimet nga paragrafi (2) i këtij neni.

(6) Secili organ kompetent i Republikës së Maqedonisë do ta njoftojë Ministrinë e Ekonomisë për vendosjen e një kërkesë të re në ligjet e posaçme për qasje ose kryerjen e shërbimi në Republikën e Maqedonisë me arsytim për shkaqet.

(7) Ministria e Ekonomisë do ta njoftojë Komisionin Evropian për kërkesat e nga paragrafët (1) dhe (6) të këtij neni. Njoftimi nuk e prolongon vendosjen e kërkesave nga paragrafi (6) i këtij neni. Nëse Komisioni Evropian vlerëson se të njëjtat janë të papërshtatshme dhe merr vendim me të cilin kërkon nga organet kompetente të Republikës së Maqedonisë të përmbahen nga vendosja e kërkesave, të njëjtat nuk do të futen ose do të shfuqizohen.

Neni 36

Ligjet e veçanta me të cilat rregullohet procedura e miratimit të qasjes në tregun e shërbimeve dhe kryerjen e shërbimeve do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 37

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen më së voni deri më 31 dhjetor 2020.

Zbatim i prolonguar

Neni 38

(1) Dispozitat e neneve 5, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 paragrafi (6), 21 paragrafi (2), 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 35 paragrafi (7) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në ditën e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

(2) Dispozitat e nenit 6 paragrafët (2), (3) dhe (4) dhe nenit 7 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2022.

Hyrja në fuqi

Neni 39

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".